



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4233 Prot.

Pogradec, më 22 . 09 . 2022

VENDIM
NR. 102, DATË 20.09.2022
PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.107 ,DATË 02.12.2021
PËR "MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË
POGRADEC PËR VITIN 2022",

Në mbështetje të ligjit nr.139,datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",të ndryshuar,ligjin nr.10926,datë 08.07.2011,"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",të ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr.69/2012 "Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec nr.107, datë 02.12.2021, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022", si dhe Relacionit të Qendrës Arsimore nr.113 prot.,datë 29.08.2022, me propozim të kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës II.17 "Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe" të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.107 ,datë 02.12.2021 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022":
 - Tarifa ushqimore ditore për kopshtin: nga 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë,bëhet 180 (njëqind e tetëdhjetë) lekë.
 - Tarifa Ushqimore për çerdhen ,nga 120 (njëqind e njëzet) lekë, bëhet 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë.
2. Ngarkohet Qendra Arsimore për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes publike.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËR

